



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2021:210233

Datë: 11.01.2022

Numri i dokumentit: 02593275

PPP.nr.40/2021

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG, si përmbarimore, me gjyqtari Individual Blerim Istrefi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit KS D. SH.A me seli në Prishtinë ish K.S C.S SH.A, kundër debitorit S.Z nga Fsh. Sh. K-Istog, për shkak të borxhit në shumë prej 169 €, pas prapësimit të ushtruar nga debitori me dt:06.09.2021 kundër urdhrorit mbi lejimin e përmbarimit P.nr.581/2021 të dt: 23.08.2021, jashtë seance gjyqësore me dt.11.01.2022 nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tersi si i pa bazuar prapësimi i debitorit S.Z nga Fsh. Sh. K-Istog, ushtruar kundër urdhrorit mbi lejimin e përmbarimit P.nr.581/2021 të dt: 23.08.2021, sipas propozimit të kreditorit KS D. SH.A me seli në Prishtinë ish K.S C.S SH.A.

A r s y e t i m

Kreditori, KS D. SH.A me seli në Prishtinë ish K.S C.S SH.A ka ushtruar propozim për përmbarim ndaj debitorit S.Z nga Fsh. Sh. K-Istog, duke kërkuar nga gjykata lejimin e përmbarimit, dhe të obligohet debitori në bazë të aktgjykimit C.nr.288/2015 të dt.25.01.2018 të paguaj shumën prej 169 € me kamat ligjore nga dt. 04.08.2014, të gjitha në afat 7 ditor nga pranimit i urdhrorit, në të kundërtën të bëjë bllokimin e llogarive bankare, sekuestrimin e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme, shitjen e tyre dhe shumën e kërkuar ta transferoi në llogari të kreditorit, të gjitha këto të specifikuar në propozimin për përmbarim të dt.23.08.2021.

Përmbaruesi privat me urdhrin P.nr.581/2021 të dt: 23.08.2021, e ka lejuar përmbarimin sipas propozimit të kreditorit.

Kundër aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit debitori S.Z nga Fsh. Sh. K-Istog, brenda afatit ligjor kanë ushtruar prapësim me shkrim, me kërkesë që i njëjti të aprovohet si i bazuar dhe të abrogohet propozimi për përmbarim, me

arsyetimin se përveç thirrjes ne kundërvajtje nga gjykata nuk kam qen i njoftuar asnjë herë deri sa e kam pranuar propozimi për përmbarim. Me tutje shton se vetura ka qen e siguruar tek KS D. kur ka ndodhur aksidenti nga dt. 03.04.2013-05.02.2014 dhe kompania duhet ti përgjigjet demit, po ashtu barra qe me vihet jam ne gjendje te rend ekonomike shëndetësore nuk kam mundëson qe ta kryej obligimin e shërbimeve ndaj kompanisë dhe më është dashur tri vite te paguaj te paguaj me tepër sigurim për shkak te aksidentit.

Kreditori, është njoftuar me prapësimin e debitorit, ku me dt. 09.09.2021 ka ushtruar përgjigje me arsyetimin se debitori ne mënyrë te pa argumentuar ka tentuar te paraqes pretendimet kinse nuk e ka ditur për borxhin, mirëpo nuk është i saktë pasi qe kreditori fillimisht e ka njoftuar debitorin përmes shkresës zyrtare pastaj ka vazhduar me padi ne gjykatë, andaj kërkojmë qe i njëjti prapsim te refuzohet si i pa bazuar.

Gjykata Themelore në Pejë - Dega në Istog, si përmbarimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP vlerësoi prapësimin e debitorit dhe thëniet e cekura në të njëjtin dhe gjeti se është i pa bazë. Arsyet e paraqitura në prapësim nuk tregojnë shkaqet sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, sipas të cilave do të pengohej përmbarimi i lejuar nga përmbaruesi privat.

Gjykata, pas shqyrtimit te prapësimi si dhe pas shqyrtimit te provave tjera ne shkresat e lëndës, si dhe pretendimeve te debitorit lidhur ne atë se nuk jam njoftuar asnjë herë me këtë borxh dhe jam i gjendjes se rend ekonomike, lidhur me pretendimet e lartcekura gjykata sqaron faktin se me aktgjykimin C.nr.288/2015 te dt. 25.01.2018 e i plotfuqishëm me dt. 21.02.2018 dhe i ekzekutueshëm me dt. 09.03.2018 ashtu qe lejimi i përmbarimit është bërë ne bazë te titullit ekzekutiv i cili vendim ne bazë te nenit 22 par.1.1 te LPP-së e ka fuqinë e titullit ekzekutiv dhe është dokument i përshtatshëm për përmbarim, shtuar faktin se debitori nuk ka ofruar asnjë provë te vetme lidhur me pretendimet e parashtruar, e ne bazë te nenit 69 par.4 parashihet se “Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”.

Se debitori ka obligim ndaj kreditorit kjo vërtetohet nga shkresat e lëndës, ma konkretisht në bazë te aktgjykimit te plotfuqishëm debitori është obliguar pagesën e borxhit tani te kërkuar ne propozim për përmbarim, andaj duke u bazuar ne nenin 245 par.1 te LMD-së i cili nen parasheh se “ Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorëve të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, ndërsa par.2 i po te njëjtit nen parasheh se “Kur debitori nuk e përmbush detyrimin ose vonohet me përmbushjen e tij, kreditori ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e demit që ka pësuar për këtë shkak”, gjykata vendosi si ne dispozitiv te këtij aktvendimi.

Gjykata pretendimet e debitorit S.Z nga Fsh. Sh. K-Istog në prapësim i refuzoj si të pabazuara për faktin se të njëjtit ishin në kundërshtim me provat e

prezantuara në vet shkresat e lëndës si dhe nuk janë te mbështetura konform nenit 69 ne lidhje me nenin 71 te LPP-së.

Gjykata, duke u bazuar në nenin 17 të LPP-së, përshtatshëmish aplikoj dispozitat ligjore të LMD-së.

Prandaj nga të lartcekurat, e duke u bazuar ne nenin 3, 22 par.1.1, 36,38, 69, 71, 73 par 3 të LPP-së (Ligjit për Procedure Përmbarimore), e lidhur me nenin 245 par.1 dhe 2 dhe 382 te LMD-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG
PPP.nr.40/2021, dt.11.01.2022

GJYQTARI
Blerim Istrefi

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit te këtij aktvendimi, Gjykatës se Apelit ne Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.